

URDHËR
Nr. 160, datë 11.3.2020

**PËR NDERPRERJEN E NDËRHYRJEVE KIRURGJIKALE TË PLANIFIKUARA
NË TË GJITHË STRUKTURAT SPITALORE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE**

(ndryshuar me urdhrin nr.218, datë 1.4.2020)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të planifikuara në të gjithë strukturat spitalore publike dhe jopublike *deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019.*
2. Përfundim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri bëjnë vetëm ndërhyrjet kirurgjikale për patologjitë malinje, të cilat do zhvillohen sipas planifikimit.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri strukturat spitalore publike dhe jopublike dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**